

Në bazë të nenit 94, paragrafi 1, pika 43, e lidhur me nenin 97, paragrafi 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/21) dhe nenin 161 të Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup (Informatori Universitar nr. 4/2019), Senati i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

për zgjedhje të rektorit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup
për periudhën mandatare 26.04.2025 deri në 25.04.2028

1. Kushtet për zgjedhje të rektorit:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - Të jetë nga rradhët e profesorëve ordinar;
2. Konkursi zgjat 7 (shtatë) ditë pune nga dita e shpalljes së konkursit në gazetata ditore dhe në web faqen e Universitetit
3. Kandidati i cili paraqitet në konkursin publik, deri te Komisioni universitar zgjedhor duhet të dorëzojë:
 - Fletparaqitje;
 - Programën e punës;
 - Të dhëna biografike dhe bibliografike;
 - Vendim për zgjedhje në thirjen profesor ordinar;
 - Tre rekomandime të besueshme;
 - Deklaratë se kandidati nuk është ushtrues i ndonjë funksioni tjetër publik ose funksioni në parti politike;
 - Certifikatën e shtetësisë;
 - E-postën;
 - telefon për kontakt.
4. Dokumentacioni dorëzohet:
 - Në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter, me dorëzim në Arkivën e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në rr. “1669” nr. 11A, Shkup, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në ora 16:00, deri te Komisioni universitar i konkursit me shënimin: “për konkursin publik për zgjedhje të rektorit”, si dhe
 - Në formë elektronike deri në ora 24:00 në ditën e fundit (me datë 31.01.2025), në postën elektronike në vijim: kuz.unt@unt.edu.mk. Nëse kandidati ka nënshkrim elektronik të lëshuar nga dhënës të autorizuar të nënshkrimeve elektronike në RMV (KIBS ose Telekom i Maqedonisë), dokumentet i nënshkruan me atë, në të kundërtën dorëzon dokumente të skanuara në PDF format, të nënshkruara me nënshkrimin personal të tij.

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup
Kryetar i Senatit